

DITARI MUJOR KORRIK 2024

NGADO TA KTHESH, ARSIM PROFESIONAL

U hapën regjistrimet për klasën e 10-të.

regjistrimi e-albania Mëso më shumë aftesi.puna.gov.al



REGJISTRIMET NË ARSIM TË MESËM PROFESIONAL JANË HAPUR

Nga Korriku shkollat e mesme të Arsimit Profesional në të gjithë vendin mirëpresin nxënësit e rinj.

Me një ofertë të larmishme, shkollat profesionale ofrojnë mbi 22 drejtime që i përshtaten aspiratave të të rinjve dhe i mbështesin ata të ndjekin ëndrrat. Aktualisht mësimet në arsimin profesional i ndjekin mbi 16,000 të rinj.


MIRATOHEN DY VENDIMET NGA KOMITETI I TRASHËGIMISË BOTËRORE I UNESCO



Komiteti i Trashëgimisë Botërore i UNESCO, mbledhur në Sesionin e 46-të të tij në New Delhi, Indi, miratoi dy vendimet që kishte në rendin e ditës për qendrat e Trashëgimisë Botërore shqiptare të Butrintit dhe Berat-Gjirokastrës. Projektvendimi për Rajonin e Liqenit të Ohrit, pavarësisht shpalljes, është planifikuar për tu diskutuar në sesionin e vitit të ardhshëm. MEKI, si përfaqësuese e shtetit tonë palë, mbështeti pa asnjë rezervë projektvendimet e Qendrës së Trashëgimisë Botërore dhe Komiteti i TB sapo i zyrtarizoi në një qëndrim unanim. Gjatë mbledhjes, ky komunitet mbështeti edhe 90% të pikave përmbajtësore të vendimit për Butrintin. Pika e vetme në të cilën shprehet keqardhje për vonesën e sqarimit është ai kufijve të pasurisë botërore. Për këtë detyrë, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja shprehet se grupi teknik i punës po e ndjek me ritëm të lartë.

SHPALLEN 22 BASHKI FITUESE PËR PROJEKTIN E INVESTIMEVE TË STREHIMIT SOCIAL! PËRFITOJNË 847 FAMILJE

Jeta e 847 familjeve në nevojë në të gjithë vendin do të përmirësohet nga “Projekti i Investimeve të Strehimit Social”. Ministri i Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja, përmes një postimi në rrjetet sociale njoftoi se janë 22 bashki fituese dhe fondi në dispozicion këtë vit është përlogaritur në masën e 490 milionë lekëve. Për të përfituar nga ky program, qytetarët aplikojnë në portalin qeveritar E-Albania dhe brenda vitit nga shpallja fitues do të përfundojë riparimi i banesave.



22 Bashki Fituese
PËR PROJEKTET E INVESTIMEVE
TË STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2024

me vlerë financimi
490
MLN LEKË nga buxheti i shtetit

Financuar nga bashkia
Financuar nga MEKI

www.meki.gov.al

PROJEKTI I MUZEUT “BESA” PJESË E LISTËS SË FINALISTËVE NË “WORLD ARCHITECTURE FESTIVAL”

Projekti i Muzeut “Besa” në Tiranë, një vepër në proces detajimi dhe planifikim financimi nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është përzgjedhur për të qenë pjesë e listës së finalistëve kandidatë për trofeun e kompeticionit “World Architecture Festival” duke konkurruar kështu me emrat më të mëdhenj të arkitekturës në botë. Ky muze do të ruajë për brezat një pasqyrë të artë të shqiptarisë, atë të shpëtimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, si edhe do t’u ofrojë të gjithëve një hapësirë opinionesh, debatesh, shprehjesh artistike e kulturore mbi tolerancën, solidaritetin dhe humanizmin.



SHQIPËRIA PËRFSHI-HET NË PROGRAMIN 2021-2027 TË CREATIVE EUROPE

Shqipëria i është shtuar listës së vendeve që kanë të drejtë të përfitojnë nga programi Creative Europe për vitet 2025-2027. Në mbledhjen e komitetit drejtues në Bruksel, ku u diskutuan ide të reja dhe strategji inovatore për të mbështetur artistët, Shqipëria u përfaqësua zyrtarisht nga Drejtoresha e Përgjithshme e Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, Znj. Anisa Pollo dhe Kryetari i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, Z. Eol Çashku. Creative Europe është programi kryesor i Komisionit European për të mbështetur sektorët e kulturës dhe audiovizualit.

MIRATOHET LIGJI QË SJELL LEHTËSIME TË REJA PËR TREGTINË SHQIPTARE

Tregtia shqiptare do të ketë lehtësime të reja pas ratifikimit në Kuvendin e Shqipërisë të Ligjit Nr. 56/2024. Ky ligj sjell dy përmirësime të rëndësishme, në rregullat e rishikuara të origjinës preferenciale dhe certifikatat elektronike të qarkullimit. Për sa i përket rregullave të rishikuara të origjinës preferenciale ato do të jenë më të thjeshta dhe fleksible, mundësojnë kumulimin bilateral, diagonal e të plotë të origjinës dhe do të lehtësojnë tregtinë ndërkombëtare duke mundësuar rritjen e eksporteve.

Me kalimin e certifikatave nga hard-copy në elektronike, kostoja do të ulet dhe shpejtësia e verifikimit do të rritet. Gjithashtu do të lehtësohen edhe procedurat doganore dhe sigurohet një sistem i sigurt verifikimi.





ZBULOHEK NJË TJETËR VARR MONUMENTAL NË PARKUN ARKEOLOGJIK TË

Zbulohet një tjetër varr monumental në hyrje të Parkut Arkeologjik të Amantias, një dëshmi e gjallë e ekzistencës së qytetërimeve të lashta ilire dhe një vlerë e shtuar e trashëgimisë e historisë sonë, që shumë shpejt do të jetë pjesë e tureve e guidave turistike.

Gërmimi arkeologjik u bë nga një ekip arkeologësh dhe restauratorësh të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, të cilët zbuluan dhe dokumentuan edhe varre të tjera me tjegulla, të së njëjtës periudhë, ndërkohë që po hartohet edhe një projekt restaurimi dhe muzealizimi për monumentin e gjetur.

PROJEKTLIGJI PËR VULLNETARIZMIN, KËRKOHEK NGRITJA E NJË DATABAZË



Zëvendësministrja e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Znj. Olta Manjani së bashku me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Znj. Bora Muzhaqi, me prezencën e Ambasadorit të BE në Shqipëri, Sh.T. Z. Silvio Gonzato dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore e organizatave joqeveritare, organizuan një takim diskutues dhe rekomandues në kuadër të hartimit të projektligjit për vullnetarizmin në Shqipëri. Fokusi i MEKI në këtë ligj është ulja e barrierave administrative dhe inkurajimi i më shumë qytetarëve për t'u angazhuar në aktivitete vullnetare, regjistrimi i vullnetarëve në databazën e AKPA, mbulimi i sigurimeve ndaj aksidenteve dhe edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e vullnetarizmit nëpërmjet fushatave të gjera informuese dhe edukuese.

HAPET PROGRAMI I VETËPUNËSIMIT, MBËSHTETJE FINANCIARE DERI NË 500 MIJË LEKË

Një lajm i mirë për të gjithë të pa punët ishte hapja e programit të vetëpunësimit. Për të gjitha ata të papunë të regjistruar si të tillë, kanë një ide biznesi dhe duan të jenë të pavarur, qeveria hap thirrjen për mbështetje financiare, deri në masën 500 mijë lekë. Përveç ndihmës financiare, punëkërkuessit e papunë me një ide të qartë biznesi, trajnohen dhe mbështeten nga ekspertë të kualifikuar.



Ke një ide biznesi dhe dëshiron të jesh i pavarur në punën tënde?



Apliko tani
puna.gov.al



Afati deri më
18 Korrik 2024

TAKIM ME PËRFAQËSUES TË FMN-SË

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja zhvilloi një takim me përfaqësues të FMN-së, Anke Weber shefe e misionit, dhe Sebastian Sosa, përfaqësues rajonal për Ballkanin Perëndimor, për të diskutuar sfidat e zhvillimit në Shqipëri dhe politikat prioritare. Në fokus të diskutimeve ishin mungesa e fuqisë punëtore dhe politikat për të adresuar faktorët strukturorë si plakja e popullsisë dhe migrimi, zhvillimi i kapitalit njerëzor përmes VET dhe trajnimit në punë, inovacioni dhe politikat për të nxitur kërkesën për punë në sektorë me vlerë të lartë të shtuar, strategjia e inovacionit dhe zhvillimet në SME.



Në takim u diskutua edhe për Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor dhe angazhimin e qeverisë shqiptare për agjendën e reformave, veçanërisht për mirëadministrimin e ndërmarrjeve shtetërore.

ANALIZA 6-MUJORE E ISHPSHSH, MË PAK AKSIDENTE NË PUNË, MË SHUMË TË ARDHURA NGA FORMALITETI

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore gjatë 6 mujorit të parë 2024 ka vijuar me kontrollet për respektimin e standardeve të punës sipas legjislacionit në fuqi nga bizneset. Gjatë kësaj periudhe janë inspektuar 4948 subjekte mbi bazë risku, 8381 subjekte të reja janë këshilluar për të drejtat dhe detyrimet nga Legjislacioni i Punës, janë realizuar 303 inspektime për shkak ankese, përkthyer ndryshe 33% më shumë krahasuar me 2023. Në këtë 6-mujor janë zgjidhur 74% të ankesave, të cilat janë në favor të punëmarrësve. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, konstatohen 38% më shumë punëmarrës informal të identifikuar. Sa i përket marrjes së masave, konstatohet se janë bërë 560 pezullime, janë dhënë 847 paralajmërime dhe vendosur 90 gjoba. Lajmi i mirë është ulja me 7% e aksidenteve në punë, krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin 2023.



JANAR-QERSHOR, SITET KULTURORE MIRËPRITËN RRETH 500 MIJË VIZITORË

Në 6-mujorin e parë të vitit, sitet tona kulturore kanë mirëpritur 499,668 vizitorë nga vendi dhe e gjithë bota. Kjo rritje është **52% më shumë krahasuar me 2023.**

Vetëm gjatë muajit qershor, numri i vizitorëve arriti në **148,896, ose 34% më shumë krahasuar me vitin e kaluar.**

Rritja e solli edhe të ardhura prej **152,500,430 lekë, ose 55% më shumë** se vitin që kemi lënë pas.



NIS PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit hap Programin Kombëtar të Praktikave të Punës. Janë 80 kuota të lira në MEKI dhe institucionet e varësisë në dispozicion për të rinjtë nga 21 deri në 26 vjeç, të cilët kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve “Bachelor”. Praktika e punës do të zhvillohet në periudhën Shtator-Dhjetor 2024 dhe pas përfundimit me sukses dhe performancës së lartë, institucionet do të bëjnë përzgjedhjen e praktikantëve që do të punësohen me kontratë 1-vjeçare.



VAZHDOJNË PUNIMET NË GALERINË KOMBËTARE TË ARTEVE

Vazhdojnë punimet rikonstruktuese në Galerinë Kombëtare të Arteve. Aktualisht po punohet me pjesën strukturore të godinës ekzistuese, për të cilën është gërmuar toka për të përforcuar themelet. Shkallët e Galerisë janë ruajtur dhe ripunuar, ndërsa hyrja kryesore do të ruajë elementët e origjinalitetit, që nga veshja dekorative e mureve të jashtme, tek gdhendja dhe zëvendësimi i tesrave në muralet ballore. Në krah të godinës ekzistuese është ngritur dhe godina e re,




për të cilën ka përfunduar karabinaja dhe struktura. Të dy objektet do të lidhen me njëri-tjetrin me ura me strukturë metalike, që do të mundësojnë lëvizshmërinë e vizitorëve. Gjithashtu ka filluar faza e punimeve me rehabilitimin e tarracës ekzistuese, muratura si dhe termoizolimi dhe hidroizolimi i të gjithë hapësirave.

RESTAUROHET KISHA E SHËN MËRISË NË MAMURRAS

Kisha e Shën Mërisë në fshatin Shënmëri, Mamurras, me status Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), tashmë është një tjetër destinacion i turizmit historik e kulturor, falë projektit për rijetësimin e saj.

Restaurimi i ka rikthyer vlerat këtij objekti kishtar që daton prej shekullit të XV.

Ndërhyrja e bërë konsiston në restaurimin dhe konsolidimin e mureve të kishës, restaurim i pikturës murale, vendosjen e një strehe metalike tek pjesa e absidës aty ku gjendet edhe piktura murale dhe pastrimin e hapësirës përreth objektit nga vegjetacioni.



104-VJETORI I BIBLIOTEKËS KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

Simbol i kulturës dhe i dijes, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë celebron 104-vjetorin e themelimit të saj. BKSH-ja është qendra arkivore e të gjitha botimeve duke mbledhur, përpunuar, restauruar, ruajtur dhe vënë në dispozicion të publikut trashëgiminë e shkruar kulturore të popullit shqiptar. Me qëllim zgjidhjen e problematikës

me ambientet dhe sigurinë e BKSH në Pallatin e Kulturës, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit po punon për të investuar në muzeimin e ekspozimin e thesareve arkivore e historike, me një koncept institucioni qendror ceremonial. Gjithashtu MEKI po punon edhe për projektin e ri të Bibliotekës Kombëtare II.



KREDI ME 0% INTERES PËR 300 PUNONJËS TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Lajmi i mirë për punonjësit e administratës publike. Për 300 prej tyre hapen aplikimet për trajtimin me kredi të lehtësuar, 0% interes, për blerjen e banesës.


Për të qenë përfitues aplikantët duhet të dorëzojnë kopje të certifikatës së pronësisë për banesën që ka në pronësi nën normat e strehimit, rivlerësimin e saj, vërtetim negativ nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, që në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron banesë e regjistruar apo në proces regjistrimi dhe marrëveshje noteriale për bashkejetuesin/en. Përfituesit do të jenë të punësuarit e Ministrisë së Brendshme, Mbrojtjes, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arsimit dhe Sportit, Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe atë të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.



MOZAIKU I TIRANËS PO MERR JETË FALË NDËRHJRJEVE RESTAURUESE

Thesari arkeologjik, Mozaiku i Tiranës, po merr jetë falë ndërhyrjes restauruese, për ta sjellë sërish në vëmendje të vizitorëve. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka ndërhyrë për ta mbajtur të gjallë këtë monument kulturor, ku aktualisht janë drejt përfundimit rifiniturat e fundit të objektit, organizimi është i tillë që mos të cenohet në asnjë moment gjendjen dhe jetëgjatësinë e objekteve arkeologjike.

Mozaiku i Tiranës, i vetmi monument arkeologjik brenda territorit të kryeqytetit, daton që prej shek. të III dhe është zbuluar në vitet 70' nga ndërtimet e një blloku pallatesh.



HAPET THIRRJA PËR “EKSPERTË TË RINJ TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË PRONËSISË INTELEKTUALE”

Hapet thirrja për programin 2-vjeçar të “Ekspertëve të Rinj të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale”. Nga kjo thirrje përfitues do të jenë 10 profesionistë të rinj, dhe synimi është përmirësimi dhe zgjerimi i aftësitë e brezit të ardhshëm të drejtuesve globalë të Pronësisë Intelektuale (PI) për të ndihmuar në ndërtimin e ekosistemeve të inovacionit, në mbarë botën. Programi zhvillohet në Gjenevë, Zvicër dhe për tu bërë pjesë e tij duhet minimumi 2 vjet përvojë, në fusha të ngjashme, aftësi të shkëlqyera analitike, kërkimore dhe organizative, aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërpersonale, anglisht e folur dhe e shkruar shkëlqyeshëm dhe njohuri ose përvojë në fushën e PI-së, inovacion ose kreativitet.



NIS KËTË VIT IMPLEMENTIMI I ARSIMIT PROFESIONAL DUAL

Si një kërkesë e vazhduar nga biznesi, nga ky vit do të fillojë të implementohet në vendin tonë, Arsimi Profesional Dual, një sistem arsimor me bazë punën në biznes në mbështetje të sektorëve prioritarë ekonomikë, bazuar në modelet më të mira të vendeve të zhvilluara si Zvicra dhe Gjermania. Kjo nismë u ndërmor me qëllim përgjigjen më së miri të kërkesave të epokës së re në të cilën ka hyrë arsimit profesional në Shqipëri. Gjatë kohës së të nxënimit



dhe praktikës njëkohësisht, nxënësit edhe do të paguhen me pagë sa minimalja me anë të Fondit Kombëtar të Arsimit. Pilotimi i kësaj nisme do të nisë në 8 bashki dhe në 10 shkolla si dhe do të angazhohen 100 biznese.

EDICIONI I PESTË I PANAIRIT TË ARTIZANATIT NË GJIROKASTËR

Në edicionin e tij të pestë, Panairi i Artizanatit në Gjirokastrë është kthyer në një traditë të bukur të qytetit, vokacion i një pasurie kulturore e shpirtërore unike e materializuar nga skalitja e gurit, gdhendja e drurit, punimi i bizhuterive, qëndisjet e plot veprave të artit që promovojnë punët e dorës dhe krijimtarinë e komuniteteve e krahinave të tëra.

Ky edicion ishte i veçantë, pasi 70 artizanëve të mbledhur nga gjithë Shqipëria në pazarin e vjetër, iu bashkuan edhe turistët që ndodheshin në qytet duke krijuar, gatuar e festuar së bashku në Gjirokastrën që i ka dyert hapur për të gjithë.



MUZEU ETNOGRAFIK I KRUIJËS RIHAPET PËR PUBLIKUN PAS RESTAURIMIT

Muzeu Etnografik i Krujës është rigjallëruar plotësisht dhe tashmë është i hapur për publikun falë restaurimit. Ky thesar arkitekturor dhe atraksion turistik, u restaurua falë programit EU4Culture, financiar nga BE dhe zbatuar nga UNOPS. I vendosur në rezidencën historike të familjes Toptani, e ndërtuar në vitin 1764, ky muze shfaq trashëgiminë e pasur kulturore të Shqipërisë. Me mbi 3000 artefakte të ekspozuara, vizitorët mund të eksplorojnë mënyrat tradicionale të jetesës së shqiptarëve dhe zakonet e tyre gjatë shekujve. Si pjesë e angazhimit tonë për ruajtjen dhe



promovimin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, projekti jo vetëm që restauron muzeun, por gjithashtu rrit ofertën e tij me teknologji moderne, duke përfshirë realitetin virtual dhe ekspozitat interaktive. Qendra Muzeore Krujë, ku përfshihet Muzeu i Gjergj Kastriotit dhe Muzeu Etnografik, ka shënuar rekorde vizitueshmërie me 75 mijë vizitorë në periudhën Janar-Qershor 2024 ose me 110% më shumë, krahasuar me 6-mujorin e parë të 2023-shit.

TË ARDHURAT NGA KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE 22.6% MË SHUMË SE NË 2023-IN

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore për periudhën janar-qershor 2024, janë rritur me rreth 66.2 miliardë lekë ose 22.6% më shumë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Efektet në rritjen e të ardhurave të kontributeve vjen edhe falë zbatimit të politikave të qeverisë, me fokus rritjen e pagave.



AGIM BAJKO DEL NË PENSION, GONXHJA: MIRËNJOHJE! MELSI QIRICI DREJTORESHA E RE QKKFTK

Pas daljes në pension të aktorit të mirënjohur Z. Agim Bajko, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja, prezantoi drejtoreshën e re të Teatrit të Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Znj. Melsi Qirici. Pjesëmarrës në ceremoninë e prezantimit të Znj. Qirici, ishte edhe Artisti i Madh Agim Bajko, ndaj të cilit nuk mungoi falënderimi dhe mirënjohja për kontributin e jashtëzakonshëm në drejtimin e QKKFTK për 4 vite me radhë.

Zgjedhja e drejtoreshës së re të Teatrit të Kukullave dhe Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, erdhi pas një gare me 7 kandidatura, nga të cilat 5 u përzgjedhën për platformë dhe 4 avancuan në intervistë.



DËGJESË PUBLIKE PËR PROJEKTIN E QENDRËS SË VIZITORËVE NË BUTRINT

U zhvillua në Butrint, Dëgjesa Publike mbi Projektin për Qendrën e Vizitorëve. Gjatë dëgjesës u prezantuan strategjia masterplanit të përgjithshëm, strategjia dhe vend parkimi i ri për vizitorët e Parkut të Butrintit, projekti i ndërtesës dhe funksioneve të Qendrës së Vizitorëve/Porta e Malit, projekti i ndërtesës dhe funksioneve të hyrjes, Porta Arkeologjike. Komentet dhe mendimet e tyre për këtë projekt të rëndësishëm i shprehën dhe përfaqësuesit, pjesëmarrësit, komuniteti dhe të interesuarit. Projekti është hartuar nga një studio arkitekture e mirënjohur ndërkombëtarisht, Kengo Kuma & Associates, në bashkëpunim me

Trashëgimia Kulturore pa Kufi – Shqipëri (CHWB), me financimin e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit (BMF) në partneritet me Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).



RRITET CILËSIA E APLIKIMEVE NË SHËRBIMET ONLINE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka rritur ndjeshëm cilësinë e shërbimeve elektronike që ofron për qytetarët, duke ju kursyer kohë dhe duke eliminuar çdo kontakt fizik me administratën. Për periudhën Janar-Qershor 2024 janë gjithsej 195,958 aplikime të realizuara online. Përmes portalit qeveritar e-Albania ISSH-ja ofron 51 aplikime dhe 4 vërtetime me vulë elektronike.



“TRASHËGIMIA DJE, SOT DHE NESËR”, TË RINJTË NGA KOSOVA E SHQIPËRIA EKSPEDITË NË SITET HISTORIKE TË ARKEOLOGJISË


Të rinjtë nga Kosova dhe Shqipëria në kuadër të programit “Trashëgimia dje, sot dhe nesër”, zhvilluan ekspeditën e tyre në sitet historike të arkeologjisë shqiptare, si pjesë e shkëmbimit rinor të organizuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, Departamentin e Rinisë të MKRS-së të Kosovës dhe në bashkëpunim me Institutin e Trashëgimisë Kulturore-MEKI. Ata u ndalën në disa pika kryesore dhe mjaft interesante si Kalaja e Ishmit, Kalaja e Bashtovës, Parku Arkeologjik i Apollonisë, Amfiteatri i Durrësit etj., ku u njohën me historinë e trashëgimisë tonë të pasur kulturore. Në këtë nismë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bashkëpunim me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, garanton mbështetjen e plotë për të shkruar një kapitull të jashtëzakonshëm për të rinjtë.



RINIS PROJEKTI KËRKIMOR SHKENCOR “LIN 3, GËRMIME ARKEOLOGJIKE NËNUJORE”

Ka rinisur Projekti kërkimor shkencor “Lin 3, Gërmime arkeologjike nënujore” me ekipin shqiptaro-zvicerian në fshatit Lin të Pogradecit. Ishin rezultatet mbresëlënëse të vitit 2023 si dhe datimet e materialit arkeologjik të realizuara në Universitetin e Bernës në Zvicër me mbështetjen e Universitetit të Oxford-it në Angli, që bindën studiuesit për intensifikimin e hulumtimeve për vitin 2024. Gërmimet në tokë dhe nën ujë, kanë rinisur në afërsi të fshatit Buqezë të Pogradecit duke nxjerrë në dritë elementë të rinj.

Gjatë këtij sezoni, arkeologët do të përqendrohen në thellimin e njohurive mbi shtrirjen e këtij vendbanimi, kompleksitetin e ndërtimit, si dhe lidhjet e tij me sitet arkeologjike të së njëjtës periudhë në pellgun e Korçës. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij zbulimi arkeologjik, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, janë duke punuar për përgatitjen e vendimit për vënien në mbrojtje dhe shpalljen e tij zonë arkeologjike, e cila pritet të finalizohet brenda vitit 2024.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË, HARMONIZIM ME STANDARDET EUROPIANE

Me qëllim eliminimin e barrierave teknike për lëvizjen e lirë të mallrave dhe rritjen e cilësisë së jetës për qytetarët shqiptarë, në 6-mujorin e parë 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ka realizuar 18,916 verifikime të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar.

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja, bëri të ditur se janë edhe 10,059 subjekte të kontrolluara si dhe 28,339,745.7 lekë të ardhura të gjeneruara.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë tha Gonxhja është në pararojë të përmirësimit të sistemit kombëtar të metrologjisë, duke e harmonizuar atë me standardet europiane.




18,916

VERIFIKIME TË INSTRUMENTEVE MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR

www.meki.gov.al